

PERMBLEDHJE JO-TEKNIKE

OBJEKTI I LEJES MJEDISORE:

"ASGJESIMI I MBETJEVE TE RREZIKSHME PERVEC INCINERIMIT (5.1A) OSE LANDFILLIMIT (5.2A) PASTRIM, LARJE, SPRUCIM OSE VESHJE E MBETJEVE TE AMBALAZHEVE / PAKETIMEVE OSE KONTENJEREVE NE MENYRE QE TE RIPERDOREN, STACION TRANSFERIMI PER MBETJE TE RREZIKSHME QE NUKPERMENDET ME LART, STACION TRANSFERIMI PER MBETJE JO TE RREZIKSHME QE NUK PERMENDET ME LART"

"V.A.L.E RECYCLING" sh.p.k

ME VENDODHJE:

Pranë Fshatit Gurrëz, Njësia Administrative Fushë Kuqe, Bashkia Kurbin, Qarku
Lezhë

Raportimi dhe interpretimi u përgatit nga subjekti:

"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Elidiana Shehu

Maj, 2023



PËRMBAJTJA

HYRJE.....	2
Kapitulli 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	3
1.1. Qëllimi i Projektit.....	3
1.1.1. Informacion për lejet dhe licensat e nevojshme për projektin.....	3
1.2. Vendodhja e zonës së impiantit	4
1.3. Informacion për qëndrat e banuara në afërsi të zonës së impiantit	5
1.4. Përshkrimi i projektit teknik.....	6
Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT	8
2.1. Mjedisi fizik	8
2.1.1. Gjeologjia	8
2.1.2. Gjeomorfologjia	9
2.1.3. Tokat	9
2.1.4. Ujërat	9
2.1.5. Klima.....	10
2.2. Mjedisi biologjik	11
2.2.1. Flora dhe habitatet	11
2.2.2. Fauna.....	13
2.3. Zonat e Mbrojtura.....	15
2.4. Cilësia e mjedisit në zonë.....	16
2.4.1. Cilësia e ujërave	16
2.4.2. Cilësia e ajrit në zonë	16
2.4.3. Menaxhimi i mbetjeve	17
2.4.4. Probleme të tjerë mjedisorë	17
2.5. Mjedisi socio-ekonomik	18
Kapitulli 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS	19
1.1. Metodika e vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis.....	19
1.2. Lloji i ndikimeve të identifikuara	19
KAPITULLI 4 PLANI I MENAXHIMIT TË MBETJEVE	22

TABELAT:

<i>Tabela 1: Koordinatat e objektit ku eshte instaluar autoklava</i>	5
<i>Tabela 2: Listat e llojeve ne zonen ne studim</i>	14
<i>Tabela 3: Rezultatet e analizave per mostrat e ujit</i>	16
<i>Tabela 4: Cilesia e ajrit mjedisor</i>	17
<i>Tabela 5: Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis</i>	22

FIGURAT:

<i>Figura 1 Pamje te objekteve dhe infrastruktures ekzistuese</i>	5
<i>Figure 2: Pozicioni I prones ne lidhje me zonat e banuara</i>	6
<i>Figure 3 Pozicionimi i pronës në lidhje me Monumentet e kulturës.</i>	16

HYRJE

Shoqëria "V.A.L.E. RECYCLING" shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) me Numër Identifikimi (NIPT): L28029301Q dhe me seli në Lezhë, Fushë Kuqe, GURËZ, Fshatin Gurëz, afër ish-Kanalit të Acidit, me administrator z. Elvis MIRI.

Kjo shoqëri ka objekt të aktivitetit: fushën e përpunimit dhe të riciklimit të mbetjeve urbane dhe eksportimit të tyre. Në fushën e grumbullimit, depozitimit të mbetjeve urbane e industriale, ndarja, përpunimi riciklimi i tyre si dhe import-eksport i tyre. Në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane në bashkëpunim me njësi të ndryshme vendore për trajtimin e tyre. Në fushën e grumbullimit, administrimit, transportimit dhe përpunimit të mbetjeve urbane, mbetjeve të posaçme dhe mbetjeve spitalore. Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve, paketimeve ose kontejnereve në mënyrë që të ripërdoren, si larje, pastrim, dezinfektim, mirëmbajtje e kontinjereve të mbetjeve urbane dhe spitalore.

Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë "Asgjesim i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lëndfillimit (5.2.a), Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren, Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme dhe Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme" me vendodhje pranë fshatit Gurrëz, Gurrëz, Fushë Kuqe, Lac, Lezhë, subjekti "V.A.L.E. RECYCLING" shpk është pajisur me leje mjedisore e tipit B me të dhënat e mëposhtme:

PN-9488-03-2015, Nr. 2421 Prot. Datë 06.04.2021, K. Nr. 11 dhe Nr. Identifikues të lejes 1780/3.

Së fundmi subjekti ka porositur dhe do të instalojë dy pajisje të tjera të tipit NEWSTER NW15 dhe NEWSTER NW50.

Ndryshimi i propozuar konsiston vetëm në shtimin e dy pajisjeve të reja tipit NEWSTER NW15 dhe NEWSTER NW50 të cilat do të shërbejnë për asgjësimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, pjese e lejes mjedisore tipi B me PN-9488-03-2015.

Parimi i funksionimit të dy pajisjeve të reja që do të instalohen është i njetje me pajisjen eksistues të tipit NEWSTER NW15 e cila është në funksionim për më shumë se 2 vite tashmë.

Instalimi i pajisjeve të reja të tipit NEWSTER NW15 dhe NEWSTER NW50 sjell rritjen e kapacitetit ditor të asgjësimit të mbetjeve duke ulur në këtë mënyrë ndjeshëm kohën e magazinimit të mbetjeve në pritje për tu trajtuar.

Kapaciteti aktual ditor i trajtimit të mbetjeve është 2.73 ton/dit.

Sipas kartave teknologjike të pajisjeve kapacitet jepet me poshtë:

- TSC – 150 ECONOS – 150 kg/ore dhe 1 cikël/ore
- NEWSTER NW15 – 30-40 kg/cikël dhe 1 cikël/40 minuta
- NEWSTER NW15 – 30-40 kg/cikël dhe 1 cikël/40 minuta
- NEWSTER NW50 – 90-110 kg/cikël dhe cikël/40 minuta

Sipas llogarive rrezulton se kapaciteti total për të gjitha pajisjet është 435 kg / orë dhe kapaciteti ditore maksimal për cdo pajisje duke kryer 13 cikle në ditë (13 cikle / 24 orë) është 5.66 ton/dit.

Edhe pse kapaciteti ditor i trajtimit të mbetjeve është rritur me instalimin e dy pajisjeve të reja të tipit NEWSTER NW15 dhe NEWSTER NW50, referuar shtojcës 1, pika 5.3 a, të ligji nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10448 dt 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, kjo rritje nuk përbën një ndryshim thelbësor që do të sjellë në këtë mënyrë edhe riklasifikimin / ndryshimin e tipit të lejes mjedisore nga tipi B në tipi A.

Me ndryshimin e propozuar, në nuk kryejmë asnjë ndryshim thelbësor në instalimin ekzistues si:

- Nuk ndryshojmë llojin e aktivitetit / instalimit;
- Nuk shtojmë llojin e aktivitetit / instalimit,
- Nuk kemi ndryshim thelbësorë në instalim;
- Nuk kemi riklasifikim të tipit të lejes mjedisore;
- Nuk shtojmë sipërfaqe;

Kapitulli 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1. Qëllimi i Projektit

Subjekti “V.A.L.E RECYCLING” sh.p.k, ka instaluar nje impiant per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme te tipit TSC-150 ECONOS me kapacitet 150 kg/h dhe Newster NW15 me kapacitet 30-40 kg/h.

Në këtë instalim do të kryhet trajtimi i mbetjeve te rrezikshme qe do te gjenerohen nga operatore private dhe publike te kujdesit shendetesore. Impianti i trajtimit te mbetjeve te rrezikshme aktualisht eshte ne regjim normal te punes duke perballuar te gjitha sasite e mbetjeve te rrezikshme qe subjekti merre ne dorezim per trajtim.

Në kuadër të funksionimit të impiantit / autoklaves dhe referuar kriterëve të monitorimit (Kushti 11) dhe dokumentimit dhe raportimit (Kushti 12), të lejes në fuqi të Mjedisit: **Leje PN-9488-03-2015, Nr. 2421 Prot. datë 06.04.2021, K. Nr. 11 dhe Nr. Identifikues 1780/3**, subjekti ka kontraktuar studion mjedisore “ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS” sh.p.k. e cila bashkëpunon me laboratorin e akredituar mjedisor “ALPHA STUDIO” sh.p.k.

1.1.1. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për zbatimin e projektit “**ASGJESIMI I MBETJEVE TE RREZIKSHME PERVEC INCINERIMIT (5.1A) OSE LANDFILLIMIT (5.2A) PASTRIM, LARJE, SPRUCIM OSE VESHJE E MBETJEVE TE AMBALAZHEVE / PAKETIMEVE OSE KONTENJEREVE NE MENYRE QE TE RIPERDOREN, STACION TRANSFERIMI PER MBETJE TE RREZIKSHME QE NUKPERMENDET ME LART, STACION TRANSFERIMI PER MBETJE JO TE RREZIKSHME QE NUK PERMENDET ME LART**”, me vendndodhje pranë Fshatit Gurres, Kurbin, Lezhë, subjekti është pajisur me:

- **PN-9488-03-2015, Nr. 2421 Prot. datë 06.04.2021, K. Nr. 11 dhe Nr. Identifikues 1780/3;**
- Kontrata ME OSHEE per piken e lidhjes me energji elektrike;
- Kontrat me ujesjellkanalizimet per furnizimin me uje;
- Kontrata me operatorët publik dhe private te kujdesit shendetesore te cilet gjenerojne keto lloje mbetjesh;
- Kontrate me landfillin e Bushatit per depozitimin e mbetjeve te ngurta te gjeneruar nga procesi i sterilizimit te mbetjeve te rrezikshme;

Gjithashtu, në kuadër të këtij projekti, subjekti ka depozituar prane AKM Regjistrin e mbetjeve per periudhen 6 mujore.

1.2. Vendodhja e zonës së impiantit

Kapanoni ne te cilen ushtrohet aktiviteti ndodhet në afërsi të fshatit Gurrëz, NJAD Fushë Kuqe, në Bashkinë e Kurbinit, pjesë administrative e Prefekturës së Lezhës. Objekti (ndërtesë 1 kat) ndodhet brënda pronës me sipërfaqe 4120 m² që subjekti “V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k ka ne pronesi.



Ortofoto të Pronës

Objekti (ndërtesë 1 kat) ndodhet brënda pronës me sipërfaqe 4120 m² që subjekti “V.A.L.E. RECYCLING” sh.p.k ka ne pronesi.

Ndërtesë 1 kat ku do te instalohen 2 pajisjet NEWSTER ndodhet ne brendesi te prones të pajisur me Certificate pasurie nga ZVRP Kurbin në Zonën Kadastrale 1673, me nr pasurie 10/8, volumi 12, faqe 26. Prona kufizohet me:

- Veri - kanal;
- Lindje - pasuria nr. 41.42.65;
- Jug - pasuria nr. 58,60,62,64;
- Perëndim - pasuria nr. 58;

Koordinatat e objektit

Nr	X	Y
1	4384964	4615576
2	4384975	4615572
3	4384972	4615563
4	4384977	4615561
5	4384974	4615552
6	4384968	4615551
7	4384965	4615542
8	4384953	4615550
9	4384954	4615557
10	4384957	4615556

Tabela 1: Koordinatat e objektit ku eshte instaluar autoklava



Figura 1 Pamje te objekteve dhe infrastruktures ekzistuese

1.3. Informacion për qëndrat e banuara në afërsi të zonës së impiantit

Nga pikëpamja administrative, prona ku ndodhet objekti 1 kat ku do te instalohen 2 pajisjet NEWSTER, i përket fshatit Gurëz, NjAd Fushë-Kuqe, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhë.

Vendi ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet në një zonë mikse urbane dhe industrial. Ne figuren 2 me poshte paraqitet pozisionimi i pronës ku do te zhvillohet projekti per asgjesimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore dhe farmaceutike. Distanca e objektit 1 kat ku do te instalohen 2 pajisjet NEWSTER ka nje distance te konsiderueshme nga lumi Mat qe rrjedh pergjat pjeses veriore dhe Perendimore te pronës, si edhe nga zonat me te aferta te banuara. Distanca nga lumi Mat eshte rreth 1 kilometer ne

Veri dhe rreth 670m ne Perendim. Distanca nga zonat e banuar me te aferta shkojne perafersisht nga 500 deri ne 800m.

Referuar distancave te objektit me zonat e banuara perreth themi se nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk do te kemi shqetesim per zonat e banuara.



Figure 2: Pozicioni I prones ne lidhje me zonat e banuara

1.4. Përshkrimi i projektit teknik

Impianti ECONOS eshte nje sterilizues mbetjesh te vecanta potencialisht irifektive. Sterilizuesi eshte i klasifikuar ne gamen e sterilizuesve me avull ne presion; procedura ndodh ne nje dhome te mbyllur ne te cilen futet avull i mbushur deri ne nje presion 3,5 Atm dhe rrezatuar me vale elektromanjetike ne frekuencen e 2,45 GHz. Ne brendesi te dhomes se sterilizimit zhvillohet nje temperature me e larte se 135° C, efekti i shumes se avullit te ngarkuar dhe presion dhe mikrovalëve, vepron duke ngrohur molekulat e ujit fragmentet materiale te te cilit jane te perbere edhe te rrethuar.

Impianti Econos mund te punoje per 24 ore ne dite. Per drejtimin e impiantit eshte i nevojshme nje operator qe duhet te zhvilloje te gjitha veprimet e ngarkim shkarkimit te mbetjes. Personeli juaj do te stervitet ne menyre te pershtatshme nga tekniket tane qe do te jene gjithmone ne disposition per nderhyrje te metjeshme, mbeshtetje per operatore, dhe ne dispozicion per fazat e start-up te impiantit.

Impianti me integrim te larte, eshte i pajisur te gjithe sherbimet e nevojshme per franksionimin e tij; realizimi konstaton nje lehtesi dhe auomatizim maksimal ne perdorim. Per perdorimin e saj eshte i nevojshme vetem nje lidhje energjie elektrike dhe uji per prodhimi e avullit

Fazat e funksionimit:

- Ngarkimi i mbetjes
- Grirja

- Levizja e mbetjes te dhomes se sterilizimit
- Sterilizimi
- Nxjerrja e mbetjes se trajtuar

Ngarkimi

Sistemi I ngarkimit parashikon futjen manuale te kontenitorit te mbetjes (kuti prej 40 ose 60 litrash). Pas futjes se mbetjes mbaron çdo kontakt ndermjet operatorit dhe ambientit rrethues deri ne daljen e mbetjes se sterilizuar. Per perdorimin e kontenitoreve te riperdorshem, sistemi parashikon larjen dhe sanitarifikimin e tyre nepermjet aparave opsionsle.

Grirja

Grirja, e ben mbetjen te padallueshme. Gjithashtu, ky trajtim lejon nje efikasitet me te madh penetrimi te avullit ne fazen e sterilizimit. Grirja ndodh ne siguri te plote, ne fakt griesja eshte e vendosur ne depresion dhe ajri ne dalje kalon nepermjet nje filtri absolut qe garanton eliminimin e patogjeneve ajror.

Sterilizimi

Eshte faza me e rendesishme dhe delikate e te gjithe procesit. Zemra e procesit eshte perbere nga nje dhome ne celik inox, e projektuar per te zhvilluar procesin e sterilizimit ne menyre te plote e te sigurt. Dhomat cilindrike ku zhvillohet procesi, nepermjet nje sistemi te kombinuar vapori te saturuar dhe mikroondes, jane te ndertuara ne ate menyre qe te lejojne nje perhapje te njetrajtshme te fushes elektrike, gjeneruar nga magnetrons, qe ngrohin ne menyre homogjene te gjithe mbetjet e futura.

Proçesi fillon me futjen e avullit ne dhomen e sterilizimit dhe sapo te jene arritur nivelet e presionit dhe temperaturat e paracaktuara, sistemi i kompjuterizuar mundeson nisjen e ciklit te sterilizimit. Gjate ciklit te sterilizimit, sistemi i agjitimit te mbetjes fillon automatikisht to levize ne menyre qe avuli te mund te mberrije te gjitha pjeset e mbetjes se permbajtur. Veprimi i mikroondes integuar me avullin garanton sterelizimin.

Aktivizimi i programuar lejon te perdoren gjeneratoret me mikroonde ne menyre te konservuar per te optimizuar furnizimin me energji. Kohezgjatja e ngrohjes eshte e ndryshueshme, ne varesi te perberjes dhe te sasise se materialit te paraqitur. Frekuenca e prodhuar nga gjeneratore eshte 2,45 Ghz, frekuenca e zgjedhur per veprimin e saj te veçante mbi molekulat e ujit (nga kjo rrjedh rendesia a injeksioneve te avullit mbi materialin per trajtim). Ekstremitetet e dhomes se sterilizimit jane kontrolluar nga nje valvul ngarkimi me gigliotine (mod. Orbinox diam. 300 mm) ne pjesen e siperme, dhe nga nje porte shkarkimi ne pjesen ballore; te dy mbylljet garantojne mbajtjen perfekte te presionit

Instalimet per trajtimin/asgjesimin dhe menaxhimin e integruar te mbetjeve spitalore:

1. Pajisja per trajtimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore (TSC-150 ECONOS)
2. Pajisja per trajtimin/asgjesimin e mbetjeve spitalore Newster NW15
3. Stacion transferimi per mbetjet e rrezikshme spitalore ne pritje te asgjësimit

4. Pastrim larje te konteniereve te mbetjeve spitalore me qellim ripërdorimi
5. Stacion transferimi per mbetjet e trajtuara spitalore ne pritje te riciklimit apo asgjesimit përfundimtar te tyre (ruajtje/magazininim i perkohshem)
6. Etiketim, ambalazhim i mbetjeve jo te rrezikshme (sterile) te dala pas trajtimit

Pajisja e re Newster NW15 ka dizajn te ri dhe ka nje sistem te ri qe ben riciklimin e ujit ne menyre qe te garantoje efektivitet maksimal, siguri dhe vazhdimej ne pune. Mbetjet ne fillim i nenshtrohen procesit mekanik te grirjes. Ne enen kryesore te sterilizimit helika e fuqishme shperben, grin dhe perzien mbetjet te cilat njekohesist nexehen nen efektin e ferkimit dhe rezistences. Temperature arriin derin ne 150°C dhe masa e mbetjeve sperkatet automatikisht me uje ne menyre qe temperature te ulet. Mbeturinat e trajtuara ftohen ne 95°C. Procesi zgjat rreth 30min ne varesi te raportit te lendes organike ne mbeturinat dhe automatikisht ndej k keto faza:

Mbetjet ngarkohen ne enen e sterilizimit Ne 60° valvula ekektrike e ujit hapet dhe fillon te njedhe ne kolonat e ftohjes. Materialet fillojne te behen pluhur dhe ne te njejten kohe temperature fillon te rritet Kur temp arrin 96-100°C dhe mbetet e qendrueshme, uji i pranishem avullon plotesisht Me pas temp. shkon ne 150°C qe eshte e dhe piku i pune fillon kthimi pas i shpejtësisë Masa e mbeturinave laget mjaftueshem deri ne 95°C. Cikli i sterilizimit eshte i kompletuar, hapet ena dheprodukti mblidhet ne kolektorin e integruar te mbetjeve Pajisja TSC-150 ECONOS

Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT

2.1. Mjedisi fizik

2.1.1. Gjeologjia

Zona ku do të përqendrohet aktiviteti për trajtimin e mbetjeve, nga pikëpamja gjeologo-tektonike bën pjesë në Ultësirën Pranadriatike. Kjo zonë ndërtohet nga shkëmbinj dhe dhera të moshave gjeologjike nga Triasiku deri në Kuaternar që i përkasin zonës tektono faciale “Mirdita”, Nenzonës “Krasta”, zonës “Kruja” dhe “Ultësirës Pranë Adriatike”(UPA).

Referuar testit rezistenca në shtypje një boshtore (Rsh) shkëmbinjtë ndahen në tre grupe:

- shkëmbinj të fortë;
- shkëmbinj mesatare;
- shkëmbinj të butë.

Kriteri i ndarjes së tyre është

Referuar kriterëve si kohezioni (c), (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse) dhe këndi i fërkimit të brendshëm (φ) dherat janë klasifikuar në tre grupe:

- dhera pa lidhje kohezionale
- dhera me lidhje kohezionale
- dhera me veti të veçanta

2.1.2. Gjeomorfologjia

Bashkia e Kurbinit shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë së Mesme në zonën midis lumenjve Mat në veri dhe Drojë në jug. Nga veriu kufizohet me bashkitë e Lezhës dhe të Mirditës, në lindje me bashkinë e Matit, në jug me bashkitë Krujë dhe Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik. Pjesa lindore e kësaj krahine është pothuajse krejt male në të cilën dallohen dy vargmale të cilat ecin pothuajse paralel me njëri tjetrin, njëri prej të cilëve ai lindor është vargmali i Skënderbeut (22 km gjatësi), ndërsa tjetri vargmali perëndimor është vargmali Krujë - Dajt.

Dy vargmalet i ndan në mes lumi i Hurdhazës që buron nga Mali i Skënderbeut në Vinjollë, kurse pjesa perëndimore është fushë. Mali i Skënderbeut nis nga Shkopeti kalon në majën e Mëllezës (1123 m) e vijon me majën e Hithit 1316 m, duke mbërritur pikën më të lartë në majën e liqenit (1724 m). Vargmali perëndimor ka pikën më të lartë në majën e Kunorës sipër Milotit (745 m) e ndjekuar afër saj nga maja e Sukës (675 m). Kurbini ndodhet 45 km larg kryeqytetit, 65 km nga porti i Durrësit, 20 km nga porti i Shëngjinit dhe 40 km larg aeroportit Kombëtar Nënë Tereza. Qyteti i Milotit është nyja lidhëse me të gjithë krahinat e Shqipërisë së Veriut e Verilindjes si kryqëzim i rrugëve kombëtare. Në territorin e sajë ka edhe një bregdet që mbetet ende i pashfrytëzuar, ku ofrohen resurse mjaft të përshtatshme për zhvillimin e turizmit (Plazhi dhe luguna e Patokut dhe Plazhi i Adriatikut).

2.1.3. Tokat

Ne zonen e propozuar për vendosjen e impiantit takohen tokat Livadhore të Hinjta Kafe dhe me pak tokat Aluvionale.

Tokat Livadhore të Hinjta Kafe janë të përhapura pothuajse në të gjithë zonen bregdetare të vendit. Keto taka formohen mbi depozitimet aluviale e deluviale në kushte të nivelit të lartë të ujerave nentokesore, i cili kushtezohet edhe nga prezenca e lumenjeve në rajon (në zonen në studim Ishmi). Tokat kanë profil të diferencuar në ngjyrë që ndryshon nga e hinjte e errët në sipërfaqe në të hinjte të zverdhur në thellesi, me përberje mekanike subargjilore e argjilore, struktura plisore me akumulime të karbonateve. Keto taka kanë një profil humusor të zgjatur rreth 30 -35 cm të trashë.

Ndërsa tokat aluvionale janë përgjithësisht të thella, me përjashtim të atyre në afërsi të bregut të lumit, që shpesh paraqiten të ceketa. Kanë ndërtim shtresor dhe horizont humusor pak të shprehur (A-C). Ndërsa një pjesë ka profil me horizont B në fillim të diferencimit (A-B-C).

2.1.4. Ujërat

Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Territori i rajonit përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Mati dhe Ishmi. Hidrografia e rajonit përbëhet prej ujërave sipërfaqësore dhe ujërave nëntokësore që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik i rajonit përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët janë Lumi i Matit, që ndan Bashkinë e Lezhës nga Bashkia e Kurbinit.

Ai ka një gjatësi 144 km, sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës rreth 2 441 km² dhe lartësi mesatare të pellgut rreth 746 m. Gjerësia e shtratit të lumit afër Milotit është rreth 1250 m, ndërsa në grykëderdhje 1000 - 1200 m. Degët kryesore të tij janë Fani dhe Uraka. Prurja mesatare vjetore në Lumin Mat

ndryshon nga 85 deri 103 m³/s. Prurja mesatare shumëvjeçare e lumit Mat në derdhje në det është 103 m³/sek, me koeficient të rrjedhjes për të gjithë pellgun ujëmbledhës 0,80. Ushqimi nëntokësor përfaqëson 30% të rrjedhjes vjetore dhe ai sipërfaqësor (nga rreshjet e shiut e borës) 70%. Vëllimi i aluvioneve pezull është mbi 2 milion ton, ndërsa moduli i aluvioneve pezull është 828 ton/km² në vit.

Ujërat nëntokësorë në territorin e Bashkisë së Kurbinit ndodhen kryesisht në zhavorret ujëmbajtëse të akuiferit të Fushë-Kuqe, Fushë - Milot, Laç. Shfrytëzimi intensiv i këtij akuiferi ka filluar që në vitin 1964 me kryerjen e një sërë shpimesh me rrotullim dhe me goditje në zonën e Fushë Kuqes dhe Adriatikut. Pas vitit 1966 hynë në shfrytëzim edhe shpimet e Milotit nga ku merren rreth 460 l/s. Po ashtu shpimet e Laçit japin rreth 250 l/s. Në këtë mënyrë nga zhavorret aluviale të pjesës jugore të pellgut të Matit (akuiferi Adriatik - Fushë - Kuqe - Laç - Milot) merren mbi 1500 l/s.

Përveç sasisë së ujërave nëntokësorë që merren si në krahun verior të Lumit Mat ashtu dhe në krahun jugor të zonës, tjetër zonë në perspektivë për marrjen e burimeve ujore suplementare është edhe grykëderdhja e vetë Lumit Mat.

Kjo pjesë kufizohet nga Rrila e Planës në veri të Lumit Mat dhe që vazhdon me Gurrzën, Fushë- Milotin dhe vetë zallishten e Lumit Mat, përbën zonën më perspektive të pellgut të Matit. Shpimet e kryera në këtë zonë kanë kapur zhavorre me trashësi mbi 100mm, të cilat formojnë një shtresë ujëmbajtëse me parametra hidraulike shumë të lartë dhe me cilësi uji shumë të mirë. Bazuar në llogaritjet e bëra në këtë zonë mund të merren rreth 2500 l/s ujë, pa ndikuar në regjimin e akuiferëve të tjerë.

Shfrytëzimi i resurseve të akuiferit është një potencial për përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave të banuara. Afërsisht 50% e banorëve, kryesisht në zonat rurale, përdorin si alternativë furnizimi ujin e puseve.

2.1.5. Klima

Në territorin e Bashkisë së Kurbinit mbizotëron klima mesdhetare, me bregdet, fusha pjellore, kodrina të ulëta, vargmale me lartësi mbi 700 m mbi nivelin e detit dhe pyje të dendur. Klima mesdhetare me verë të nxehtë e të thatë e dimër të butë e të freskët, është tipike për zonën fushore e kodrinore, ndërsa në zonën malore bie dëborë në dimër. Trashësia mesatare e dëborës shkon mesatarisht deri në 50 cm. Karakteristike për çdo stinë të vitit janë erërat e forta që fryjnë nga verilindja dhe lindja e drejtohen nga korridoret natyrore, shpatet e maleve, që si rezultat i ngritjes së nivelit të shtratit të lumit Mat nga ndërtimi i baseneve të hidrocentraleve ku shpejtësia e tyre arrin deri në 100 km/h sidomos në periudhën e dimrit.

Temperaturat minimale absolute marrin vlera nga -3 deri -5 °C; vetëm në raste shumë të rralla mund të vrojtohen temperatura më të ulta se këto vlera. Periudha e ngricave është shumë e shkurtër dhe numri i ditëve me ngrica mund të marrë vlera nga 12 deri 15 në vit, gjatë të cilave vlera e temperaturës minimale mund të bjerë nën 0°C. Për sa i përket temperaturave maksimale absolute vlerat e tyre rrallë herë e kalojnë vlerën 35-36°C. Vlera me e lartë e temperaturës maksimale absolute është 39.0°C.

Sasia mesatare vjetore e reshjeve është nën mesataren e vendit tonë. Vlerat mesatare më të larta arrihen në muajt e dimrit ndërsa më të ulta në muajin Korrik. Sasia mesatare e reshjeve vjetore ka vlerën 1299 mm.

Era në zonën në studim fryn përgjithësisht nga dy drejtime. Gjatë gjysmës së ftohtë mbizotëron juglindja, pa përjashtuar veriu. Në gjysmën e ngrohtë mbizotëron veriperëndimi. Shpejtësitë e erës në zonën në studim kanë vlera mesatare.

2.2. Mjedi biologjik

2.2.1. Flora dhe habitatet

Mbas njohjes dhe vërtetimit në zonën e studimit janë plotësuar të dhëna të përgjithshme për vendodhjen, sipërfaqen, pjerrësinë, kundrejtimin e diellit, përbërjen floristike, dhe sasi-mbulesën. Vlerësimi i florës është bërë duke ndjekur metodikën e vlerësimit të shpejtë, e cila ka si qëllim inventarizimin e llojeve, përcaktimin e sasi mbulesës, lidhjen e ndërsjelltë midis formacionit tokësor dhe bimësisë, si dhe faktorët që ndikojnë në habitatin në studim. Gjithashtu, mbas njohjes së zonës që është objekt studimi janë përcaktuar dhe transektet (me gjatësi nga 100 – 200 m) që janë ndjekur bazuar në mbulesën bimore përfaqësuese.

Më poshtë jepet një përshkrim më i detajuar për llojet floristike të vëzhguara drejtpërdrejt në zonën e studimit.

a) Tokat natyrore dhe gjysme-natyrore me bar

Tokat natyrore dhe gjysmë-natyrore me bar kanë shtrirje të gjerë brenda zonës së studimit. Ato janë në stadi të ndryshme degradimi, si pasojë e shkallës së lartë të shqetësimit prej afërsisë me zonat e banuara. Në 80% të tyre, këto toka mbulojnë nga bimesi barishtore të mbirë spontanisht që përfshijnë lloje me valencë ekologjike të lartë. Zhvillim dhe përhapje më të qëndrueshme më së shumti kanë llojet e familjes Graminacea.

Ky lloj habitati ka shtrirje të fragmentuar për shkak të shkallës së lartë të shqetësimit (kullotjes, shkeljes, etj). Diversiteti i llojeve të faunës që strehon zona është shumë i ulët, megjithatë ajo vizitohet nga shumë lloje të tjera që janë të lidhur me mjediset kufizuese të zonës në studim, por që e vizitojnë atë në kërkim të ushqimit, ose që thjesht e përdorin si korridor kalimi.

Këto habitate gjithashtu mbështesin një sërë myshqesh, likenesh dhe fieresh, shpesh të dominuara nga Fieri (*Pteridium aquilinum*). Këto habitate konsiderohen me vlera të larta natyrore dhe janë të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të kushteve hidrologjike dhe ndotjes ujore.

b) Habitati i pyjeve breglumore

Pyjet aluvial që formohen përgjatë shtratit të lumit Mat, bëjnë pjesë në habitatet Evropiane që përfshijnë 92A0 galeri me Shelg të bardhë (*Salix alba*) dhe Plep të bardhë (*Populus alba*) dhe 92C0 pyje Rrapi (*Platanus orientalis*), të cilat i përkasin aleancës *Platanion orientalis*. Ky formacion krijon një mjedis të përshtatshëm për mbrojtjen e brigjeve, tokës, faunën dhe zhvillimin e turizmit.

c) Toka të Lagështa (Ujë i Ndenjur)

Lumi i Matit dhe brigjet e tij, përbëjnë zona të rëndësishme për botën e egër, nëpërmjet pellgjeve ujore në brendësi të territorit dhe habitateve moçalore të bregut. Përgjithësisht këto mjedise ujore

karakterizohen nga ujë i qartë me status ushqyesish të varfër deri mesatar. Në disa vende, komunitetet e bimëve ujore dominohen nga Kallamishte (*Phragmites australis*) dhe Shavar gjethengushtë (*Typha angustifolia*).

Këto specie konsiderohen si të zakonshme si në shkallë lokale ashtu edhe kombëtare dhe vlera e botanike e bimësisë në këtë habitat, përgjithësisht konsiderohet si e mesme. Megjithatë tokat ujore, si dhe habitatet e përrenjve dhe lumenjve janë të një interesi të lartë ekologjik për shkak të përhapjes së kufizuar në rang vendi.

d) Habitatat e tokave bujqësore

Tokat bujqësore janë mjaft të përhapura në zonën e studimit, për shkak të afërsisë me zonat e banuara (fshati Gurrëz). Kulturat kryesore të kultivuara përfshijnë lloje si: Elbi (*Hordeum vulgare*), misër (*Zea mays*), jonxhë (*Medicago sativa*), domate (*Solanum lycopersicum*), patatja (*Solanum tuberosum*), patllëxhani (*Solanum melongena*), qepa (*Allium cepa*), hudhra (*A. sativum*), Kungulli (*Curcubita maxima*), kastravec (*Cucumis sativus*), etj. Hortikultura në zonën e studimit është e përfaqësuar nga hardhitë e rrushit, fiku, limoni, portokalli, shega, arra, etj. Ndërkohë, sipërfaqe të tjera dikur toka bujqësore por tashmë të braktisura, kanë prirjen të mbuloen nga bimësi oportuniste si manaferra (*Rubus ulmifolius*), mëgashtra (*Dittrichia viscosa*).

e) Të dhëna mbi kompleksin ligatinor të Patokut

Zona e projektit kufizohet në krahun jugor dhe jug perëndëmor me Kompleksin ligatinor të Patokut. Sipas studimeve të ngjashtë të publikuara për zonën, në të janë evidentuar rreth 358 specie bimësh të larta. Nga këta 4 janë me statusin ndërkombëtar të specieve të rralla, 8 lloje në rrezik zhdukje, dhe 6 në përkeqësim të dukshëm. Fundi i lagunës, karakterizohet nga prania e livadheve nënujore të dominuar nga fanerogamet Leshteriku i Noltit (*Zostera noltii*) dhe Rupia e perdredhur (*Ruppia cirrhosa*).

Përreth ujërave zhvillohet kryesisht bimësi hidrofile, e përfaqësuar nga kallamishtet (*Phragmites*), shavari (*Thypha* sp.) dhe zuba (*Scirpus*). Në pjesën veriore dhe jugore të lagunës, dhe vecanërisht në zonat me më pak kripë dominojnë llojet si Kalitriku (*Callitriche truncata*), Hara (*Chara* spp.), Tolipela (*Tolypella* spp.), Ambruku (*Salicornia* spp.), Artroknema (*Arthrocnemum* spp.), Cimla e sodes (*Salsola soda*), Fshesa e rendomte (*Limonium* spp.), Eleocharis parvula, bari i kenetave (*Lemna trisulca*), Zhabina (*Ranunculus* spp.), etj.

Si ekosisteme, në tërësi lagunat bregdetare janë mjaft prodhuese dhe mbështesin një llojshmëri habitatesh të tjerë, duke përfshirë moçalet e kripura dhe livadhe nënujore detare. Ato, gjithashtu shërbejnë si habitate të domosdoshme për shumë lloje peshqish dhe kafshësh me guaskë. Mbi të gjitha i gjithë kompleksi ligatinor i Patokut, si dhe zona pranë grykëdedhjes së lumit Mat, kanë rëndësi për shëndët dimëruës.



Foto. Tipet e habitateve ne zonen e projektit.

2.2.2. Fauna

Bazuar në vrojtimit në terren, në botimet e publikuara për zonat në afërsi, si dhe në kërkesën e llojit për habitat, vlerësohet se në zonën në studim gjenden 84 lloje vertebrore, ku përfshihen amfibë, reptilë, shpendë dhe gjitarë. 10 lloje vertebrorësh u vrojtuan në terren gjatë monitorimit. Ndërkohë, vlerësohet së në bazë të kërkesës së llojit për habitat, shpërndarjes gjeografike dhe ekologjisë së llojeve, në zonën e marrë në studim mund të gjenden edhe 89 lloje të tjera. Nga totali i kafshëve të evidentuara, 11 lloje janë me status të ekspozuar ndaj rrezikut (VU), 6 lloje janë me status në rrezik (EN), 8 lloje janë vlerësuar me rrezik të ulët (LR), 1 lloj është i kërcënuar në mënyrë kritike (CR) dhe për 5 lloje nuk ka të dhëna të sakta. Në tabelën e mëposhtme (Tabela 8) jepen të dhëna mbi numrin e llojeve të rrezikuara.

Grupi	Numri i llojeve	Stausi kombetar
Amfibët	5	5
Reptilët	7	4

Shpendët	58	22
Gjitarët	14	9
Total i vertebrorëve	84	40

Tabela 2: Listat e llojeve ne zonen ne studim

Gjitarët - Zona në studim ka numër të vogël llojesh të gjitarëve dhe me densitet të vogël popullate, për shkak të homogjenitetit dhe karakteristikave specifike të habitateve. Diversiteti i llojeve rritet referuar më tepër habitateve kufizuese të zonës në studim, duke bërë që lloje të ndryshme, megjithëse nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejt me zonën e projektit, e vizitojnë atë në kërkim të ushqimi, ose e përdorin si rrugë kalimi. Vleresohet së në total në zonë janë të pranishme 14 lloje gjitarësh. Nga këto vetëm 2 lloje janë evidentuar gjatë punës në terren (fece, gjurmë). Ky grup përfaqësohet kryesisht nga dhelpra (*V. Vulpes*), çakalli (*C. aureus*), baldosa (*M. meles*) dhe Lunderza (*L. lutra*).

Shpendët – Zona e projektit kufizohet në krahun jugor dhe jugperëndimor me kompleksin ligatinor të Patok – Fushë Kuqe, e cila përbën një ndër zonat më të rëndësishme në Shqipëri për shpendët baltake (*Charadriiformes*). Ajo është një ndër 14 zonat e rëndësishme për Shpendët (*Iba*) në Shqipëri. Studime të ngjashme të kryera për zonën tregojnë se në Zonën e Menaxhuar të Patokut folezojnë 60 lloje shpendësh. Si shpend me karakteristike të habitateve ligatinore të kësaj zone janë karabullaku i vogël (*Microcarbo pygmeus*), çafka e vogël e bardhë (*Egretta garzetta*), çapka e madhe (*E. alba*), Çapka e përhimtë (*A. cinerea*), kryekuqja (*Ana penelope*), marsatorja (*Anas querquedula*), huta (*Buteo buteo*), shqipja e kenetës (*Circus aeruginosus*), vraponjësi gushëbardhë (*Charadrius alexandrinus*), kojliku i madh (*Numenius arquata*), pulëbardha e zakonshme (*Larus ridibundus*), etj.

Reptilët – Diversiteti i reptilëve në zonën e studimit vlerësohet i ulët në lloje. Në bazë të studimeve vlerësohet se në këtë zonë janë të pranishme 7 lloje reptilesh. Më të zakonshmit përfaqësohen nga: Gjarpri i ujit (*Natrix natrix* dhe *Natrix tessellata*), Breshka e zakonshme (*Testudo hermanni*), Breshkëujëza (*Emys orbicularis*), si dhe si Zhapiu i gjelbër (*Lacerta viridis*) dhe hardhucat (*Podarcis muralis*, *Podarcis taurica*). Këto të fundit janë më të përhapur në mjediset e thata përreth zonës së studimit. Nga këta, 4 lloje janë me statusin pak të kërcënuar (LR).

Amfibët – Numri i llojeve të amfibeve në zonën e projektit është mjaft i vogël krahasuar me llojet e grupeve të tjerë faunistike. Ata shfaqen kryesisht përgjatë kënetave, kanaleve kullues dhe depresioneve midis dunave të vjetra të mbushura me ujë të embël, kryesisht në kufi me zonën e studimit. Llojet më të zakonshme janë Bretkosa e gjelbër e zakonshme (*Pelophylax kurtmuelleri*) (VU), Bretkosa kercimtare (*Rana dalmatina*), Bretkosa barkverdhë (*Bombina variegata*), dhe Thithlopat (*Bufo bufo*, *Bufo viridis*).



Foto : Gjarpri i madhe i ujit (*N. natrix*) dhe Hutes (*B. Buteo*)

2.3. Zonat e Mbrojtura

Një rëndësi të veçantë për vlerat e tyre historike, shkencore, estetike apo turistike janë dhe monumentet natyrore, të cilët sipas klasifikimit të IUCN, bëjnë pjesë në kategorinë e III të zonave të mbrojtura.

Në afersi të zonës së projektit takohet një numër i konsideruesh monumentesh natyrore, të cilët shtrihen pothuajse në të gjithë sipërfaqen Qarkut Leshë, ndër të cilat përmendim.

Rëra e hedhur

Dritarja tektonike e Mirditës

Rrapi i Grykës

Këneta e Kashtës

Rrepet e Kolshit

Rrapi i Pirajve

Shpella e Hutit

Lisi Markatonajt

Shpella e Sukës së Vogël

Pylli i Shënmërisë në Kallmet



2.4. Cilësia e mjedisit në zonë

2.4.1. Cilësia e ujërave

Hidrografia e rajonit përbëhet prej ujërave sipërfaqësorë dhe ujërave nëntokësorë që gjenden në akuiferët kryesorë të zonës në studim. Rrjeti hidrografik i rajonit përbëhet prej disa lumenjve, ku ndër më kryesorët janë Lumi i Matit, që ndan Bashkinë e Lezhës nga Bashkia e Kurbinit.

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësor per lumen Mate, duke perfaqësuar gjithë gjatësinë e lumit në rrjedhjen e sipërme, në rrjedhjen e mesme dhe në rrjedhjen e poshtme është realizuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Klasifikohet si një basen me cilësi shumë të mirë, cilësi e pare në të gjitha stacionet e monitoruara. Ujërat e këtij baseni kanë përmbajtje të lart të sasisë së oksigjenit të tretur që varion nga 8.6-9.3mg/l (norma >7).

Referuar faktit që subjekti aktualisht ushtron aktivitetin e trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore me autoklave, në zbatim të kushteve të lejes Mjedisore që disponon për këto aktivitete, janë bërë monitorimet e ujërave.

Mostrat e ujit janë marrë në shkarkimet sipërfaqësore pranë impiantit sterilizues. Rezultatet e analizave jepen me poshte:

Parametrat e matur	Ujrat e shkarkimeve	Norma e lejuar
Ph	7.28	6-9
Percj. Elektrike $\mu\text{S}/\text{cm}$	685	2000
TN, mg/l	0.97	10
TC, mg/l	5.42	20
Lenda suspense, mg/l	2.00	50
COD, mg O ₂ /l	1.44	160

Tabela 3: Rezultatet e analizave për mostrat e ujit

2.4.2. Cilësia e ajrit në zonë

Përsa i përket cilësisë së ajrit në zonën e projektit, edhe pse trafiku i mjeteve të rënda, që dikur ka qënë i rënduar, sot është lehtësuar, si rezultat i shkarkimit të këtij trafiku në superstradën Tiranë – Shkodër cilësia e ajrit nuk është përmirësuar. Kjo për faktin se 60% e automjeteve që qarkullojnë përreth zonës së projektit janë automjete diesel dhe janë prodhim i viteve 90'. Ky fakt sjell përkeqësimin e cilësisë së ajrit. Gjenerues të tjerë të shkarkimeve në ajër janë aktivitetet e furrave të bukës të cilat punojnë me solar, fabrika e tullave, si dhe rastet e djegies abuzive të mbetjeve.

Rritja e numrit të automjeteve në qarkullim, veçanërisht në periudhën e verës, mosaplikimi i masave zbutëse për uljen e sasisë së pluhurit nga ana e aktiviteteve ndërtues, ndryshimi i regjimit vjetor të erërave, ndikojnë negativisht në përkeqësimin e cilësisë së ajrit në zonën e projektit. Deri më sot, nuk ka patur monitorim të ajrit nga institucionet perkatese, për të bërë të mundur vlerësimin e respektimit

të limiteve përkatëse. Megjithatë subjekti ka kryer një vetmonitorim për të bërë një vlerësim të cilësive së ajrit në ambientet që disponon.

Jane kryer katër matje të cilësive së ajrit, në katër drejtimet periferike të oborrit të godines ku do të instalohen 2 pajisjet NEWSTER. Matjet u kryen në kushte atmosferike normale për periudhën Tetor 2022 – Mars 2023 pa prani të reshjeve të shiut. Rezultatet e hollesishëm jepen me poshte:

Tabela 4: Cilësia e ajrit mjedisor

Vendi i matjes	Pika 1	Pika 2	Pika 3	Pika 4	Norma e lejuar
TSP, $\mu\text{g}/\text{m}^3$	84	94	95	86	140
PM10, $\mu\text{g}/\text{m}^3$	38	44	43	41	60
SO ₂ , $\mu\text{g}/\text{m}^3$	26	19	18	16	60
NO ₂ , $\mu\text{g}/\text{m}^3$	32	18	18	16	60
CO, mg/m^3	1.2	0.7	0.7	0.6	2

2.4.3. Menaxhimi i mbetjeve

Mbetjet urbane gjenerohen nga burime shtëpiake, administrata shtetërore, sektori i ndërtimit, fabrikat e përpunimit të peshkut dhe birrës, shërbimet e ndryshme, porti i Shengjinit, depozitat e naftës, etj. Mbetjet e prodhuara grumbullohen pa asnjë ndarje paraprake, ndërsa bashkë me to grumbullohen edhe mbetje të tjera të rrezikshme (p.sh. bateritë, kimikate, etj).

Mbetjet e grumbulluar depozitohen në një vendepozitim në zonën e Bërzanës, në të cilin proceset e parashikuara janë vetëm ngjeshja, nivelimi dhe dezinfektimi i mbetjeve të depozituara. Vendepozitimi nuk plotëson asnjë prej kushteve të kërkuara për një qendër depozitimi të kontrolluar: nuk ka sistem të evakuimit dhe trajtimit të liksivateve, të evakuimit të ujërave atmosferike apo të mbledhjes dhe djegies së biogazit. Nga ana gjeoteknike, terreni paraqet risk të lartë erozioni dhe paqëndrueshmërie. Nuk ka rrethim përgjatë perimetrit dhe ende nuk ka studime lidhur me potencialin kontaminues nga aktiviteti i tij.

Problem i pazgjidhur mbetet edhe trajtimi i mbetjeve spitalore, për të cilat ende nuk studime lidhur me sasitë dhe tipologjitë e prodhuara. Trajtimi i vetëm i rezervuar për mbetjet të rrezikshme spitalore, është depozitimi i tyre në një vend të caktuar në vendepozitim në Bërzane dhe mbulimi me dhe.

Si rrjedhojë, rajoni po përballet me një situatë të pakëndshme për administrimin e mbetjeve jo vetëm në qytet, fshatra dhe rrugë, por edhe në fushat e hedhjes së tyre. Sasi të konsiderueshme mbetjesh urbane janë depozituar në pjesët anësore të rrugëve, duke mbushur kanalet kulluese jo vetëm me to, por, në disa raste, edhe me mbetje të rrezikshme.

2.4.4. Probleme të tjerë mjedisorë

Zona në të cilën do të ushtrohet aktiviteti është një zonë mikse industriale dhe urbane. Presionet kryesore në lidhje me mjedisin në këtë zonë janë shkarkimet e mbetjeve në ujrat e lumit Mat si edhe aktiviteti i shfrytëzimit të inerteve në këtë lum. Përveç këtyre aktiviteteve që janë evidentuar si presione kryesore në mjedisin e zonës vlen të përmendim edhe përfshirjen në një zonë të mbrojtur megjithatë në kufijtë periferike të saj ushtrimi i një aktiviteti të tillë është një presion shtesë në zonë.

2.5. Mjedisi socio-ekonomik

Administrativisht zona në të cilën do të ndërtohet / instalohen 2 pajisjet NEWSTER per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore dhe farmaceutike me ane te procesit te sterilizimit ne temperatura te larta, ndodhet në fshatin Gures, Njësia Administrative Fushe Kuqe, Bashkia Kurbin, Qarku Lezhe.

Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Kurbin ka 46,291 banorë, ndërsa sipas regjistrimit civil ka 72,987 banorë. Me një sipërfaqe prej 269.03 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 172 banorë km², ndërsa sipas Regjistrimit Civil, densiteti është 271 banorë km².

Popullsia është e përzjerë me prurje nga shumë anë të vendit gjatë kohës së komunizmit. Mbyllja e industrisë solli probleme të rënda ekonomike dhe sociale për zonën, e cila sot ka një shkallë të theksuar të kriminalitetit.

Aktorët e shoqërisë civile në qytet kanë shqetësim të veçantë mungesën e vendeve të punës dhe praninë e lartë të lokaleve të bixhozit apo basteve sportive. Në zonat rurale shqetësim përbën mosmirëmbajtja e rrjetit të kullimit dhe vaditjes.

Kurbini gjendet përgjatë aksit rrugor dhe hekurudhor veri-jug, gjë që ka sjellë edhe zhvillimin e shërbimeve të transportit. Qyteti i Laçit, i cili ka një të tretën e popullsisë së bashkisë së re, është një zonë ish-industriale dhe është krijuar si qytet përreth fabrikave të Superfosfatit dhe të pasurimit të bakrit, që të dyja të mbyllura shumë kohë më parë. Fasoni ka zëvendësuar këto fabrika si burimi kryesor i punësimit në qytet. Megjithatë, sot funksionon vetëm një fabrikë të prodhimit të këpucëve, ku janë të punësuar 100 gra. Papunësia është tepër e lartë.

Bashkia e re Kurbin shtrihet në një zonë bujqësore dhe pjesërisht malore në Shqipërinë qendrore dhe ka një vijë bregdetare, që shtrihet në rezervatin natyror Patok-Fushë Kuqe. Pjesa tjetër e bashkisë është zonë bujqësore, ndërsa me rëndësi konsiderohet Laguna e Patokut, e cila është zhvilluar si zonë peshkimi dhe qendër e turizmit ditor. Kurbini ka një reliev të larmishëm, me fusha në pjesën perendimore, në pjesën lindore me male dhe në veri lugina e Matit.

Aktivitetet kryesore janë bujqësia dhe blegtoaria gjë që kushtëzon edhe përdorimin e tokave për qëllime blegtorale dhe bujqësore. Faktoret klimaterike, gjeologjike e morfologjike kanë kushtëzuar një zonë ku mbizotërojnë tokat e hirta-kafe. Varfëria në humus e tokave ka kushtëzuar përdorimin e tyre si kullota të varfëra. Zona i është nënshtruar ndikimit të veprimit të njeriut.

Kapitulli 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë është bërë duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e kushteve dhe vlerave egzistuese të zonës së projektit, faktorëve favorizues dhe kufizues mjedisorë për zhvillimin e projektit dhe zonave të ndjeshme fizike dhe shoqërore të identifikuar gjatë punës në terren.

1.1. Metodika e vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis nga zhvillimi i këtij projekti, u ndoqen hapat e mëposhtme;

- Njohja me bazen ligjore në fuqi;
- Njohja me projektin e zbatimit dhe teknologjinë që të përdoret;
- Njohja me ciklin e trajtimit të mbetjeve;
- Njohja me lëndët e para dhe mjetet që do të përdoren;
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese të zonës ku do të zhvillohet projekti;
- Njohja dhe shkelja nga afer e të gjithë zonës së studimit për vlerat natyrore dhe mjedisore;
- Njohja me dokumenta dhe raporte të VNM dhe veprimtarive të ngjashme;
- Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- Konsultimi me banorët e zonës dhe njësinë e qeverisjes vendore;

1.2. Lloji i ndikimeve të identifikuar

Ndikimet e mundshme në mjedis të trajtimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe farmaceutike janë të lidhura vetëm me fazën e zhvillimit të veprimtarisë. Trajtimi i mbetjeve spitalore dhe farmaceutike me një nga teknologjitë standarte dhe të aprovuara e të çertifikuara në kushtet kur aktualisht administrimi i tyre bazuar në kërkesat ligjore është pothuajse inekzistent, pritet të ketë më shumë pasoja të karakterit pozitiv.

Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje e ndikimeve që mund të shkaktohen nga zhvillimi i veprimtarisë së propozuar ndërsa në paragrafët e mëposhtëm bëhet një analizë më e detajuar e tyre.

Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis					
Mjedisi pritis	përkruaj	Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis	Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuara (shkalla)	Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe indirekte)	Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj)
Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së veprimtarisë	Nuk ka sepse nuk ka ndërtime apo punime të hapura dhe masive. Veprimtaria është egzistuese.	N/A	N/A	N/A	Objekti në të cilën do të instalohet impianti i ri është egzistues me të njëjtë fushe aktiviteti
Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së veprimtarisë	Nuk ka. Veprimtaria do të zhvillohet në një objekt egzistues dhe përdor teknologji që nuk ka shkarkime ne ajer, pajisja punon me energji elektrike dhe nuk gjeneron shkarkime.	N/A	N/A	N/A	Magazina është egzistuese dhe është legalizuar vitin e fundit.
Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve	Nga procedsi I sterilizimit do te gjenerohen mbetje urbane jo te rezikshme te cilat do te shoqerohen me testi n e negativitetit. Qe do te thote qe gjithe ngarkesa bakteriale e mbetjeve eshte asgjesuar dhe keto konsiderohen si mbetje urbane te cilat do te vendepozitohen ne landfillin e Bushatit.	N/A	N/A	N/A	
Ndikimet sociale të projektit të tilla	Nuk ka. Objekti është ekzistues dhe është tokë	N/A	N/A	N/A	N/A

si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet si përdorimi i burimeve natyrore etj.)	private.				
Në varësi të natyrës të projektit përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis	<p>Procese që ekspozon pasoja në mjedis janë operacionet e transportit dhe paratrazhimit.</p> <p>Të tilla përfshijnë dëmtimin e kontenierëve dhe qeseve të grumbullimit të mbetjeve dhe derdhjen e mbetjeve në mjediset e spitaleve, gjatë rrugës apo në ambientet e magazinimit përpara se ti nenshtrohen procesit të sterilizimit.</p> <p>Aksidente të mundshme janë rënia e zjarrit, dëmtimi i punonjësve dhe përballimi i një rast përmytjeje natyrore.</p>	Analitik/ logjik	E lokalizuar	Direkte / indirekte	Ambjentet e punës në qendrat shëndetësore dhe në ambientet e magazinimit
Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit (nëse ka të tilla)	Nuk ka pasi zona ku do të zhvillohet projekti është në brendësi të territorit të Republikës së Shqipërisë.	N/A	N/A	N/A	N/A
Ndikimet pozitive në mjedis	Do të shmangë rrezikun e ndotjes së mjedisit nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve spitalore dhe farmaceutike me rrezik biologjik. Ndotja e mjedisit nga mbetjet e rrezikshme spitalore dhe farmaceutike është një shqetësim	Përputhja e trajtimit me standartet	Referuar territorit që do mbulojnë kontratat e shërbimit	N/A	N/A

	madhor për Shqipërinë.				
Ndikimi social	Ndikimet sociale të projektit janë me kah pozitiv. Shërbimet e ofruara nëpërmjet kontratave të shërbimit rrisin sigurinë shëndetësore e sociale. Ndotja e mjedisit nga mbetjet spitalore dhe farmaceutike përbëjnë rrezik për shëndetin publik dhe është një shqetësim madhor për Shqipërinë.	Përputhja e trajtimit me standartetP ërmirësimi i sigurisë së shëndetit publik dhe mjedisor	Referuar territorit që do mbulojnë kontratat e shërbimit	N/A	N/A

N/A – nuk aplikohet (ska ndikim)

Tabela 5: Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

KAPITULLI 4 PLANI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
1.	Prodhimi dhe grumbullimi i mbetjeve	Vendosja e koshave ne perputhje me nevojat dhe marrveshjen me administraten e qendrave shendetesore, klinikave shendetesore, laboratore, klinike dentare, etj	Disponibiliteti i mjaftueshem dhe ne kohe	Personeli i autorizuar i subjektit	Sipas planit te investimeve dhe ne vazhdim
Vendosja e sinjalistikes perkatese		Etiketimi i koshave ne perputhje me percaktimet e VKM 798. Çdo kontenitor ka te nenvizuar indikacionet e klasifikimit te mbetjes dhe rezikut qe mbart, indikacionet jane te shkruara dhe ne ilustruara grafikisht ne menyre qe te perdoren rregullisht.	Personeli i autorizuar i subjektit	Sipas planit te investimeve dhe ne vazhdim	

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikatoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjesitë	Koha, periudha
		Inspektimi dhe kujdesi për sigurinë e koshave	Rregjistrimi i inspektimeve dhe rezultateve perkatëse	Personeli i autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore
2.	Terheqja, transporti dhe magazinimi në piken e paratrajtimit	Sigurimi i karrove/mjeteve të transportit të brendshëm	Disponueshmëria e mjeteve	Personeli i autorizuar i subjektit	Sipas planit të investimeve dhe në vazhdim
		Sigurimi i mjeteve mbrojtëse për personelin	Disponueshmëria e mjeteve (doreza etj)	Personeli i autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore
		Terheqja e mbetjeve sipas frekuencës së nevojshme dhe koordinuar me stafet e qendrave shëndetsore	Rregjistrimi i terheqjes së mbetjeve.	Personeli i autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/dite
3.	Trajtimi në impiantin e mbetjeve	Kontrolli i mbeturinave në hyrje. Kontrolli i mbetjeve të magazinuara, konsiston në shqyrtimin e mbeturinave të depozituara në zonën e magazinimit/stokazhit, me qëllim kontrollin e ambalazhit ose paketimeve të gabuara. Duhet të kontrollohen koha e mbetjes në stokazh që nuk duhet të kalojë limitin kohor të caktuar.	Zbatimi i procedurës dhe rregjistrimi i saj.	Personeli i autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikatoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
		Duhet bere verifikimi dhe prezenca e e materialeve qe nuk jane pjese e aktiviteve te sherbimit te dhene per koncesion			
		Kontrolli i materialeve te konsumueshme ne dizposicion, para se te filloj trajtimi duhet bere verifikimi i sasise se materialeve te disponueshme, si qeset e trajtimit per mbeturinat, dispozitivat mbrojtës te operatorve etj. Kontrolli i materialeve ose kontrolli fillestar na lejon qe te perdorim skortat. E disponueshme dhe shmang jo produktivitetin/ mos venien ne pune te makines.	Zbatimi i procedures dhe rregjistrimi i saj.	Personeli autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore
		Trajtimi sipas procedures dhe parametrave teknike te impiantit., perfshi dhe rregjistrimi dhe raportimin e te dhenave per sasite e mbetjeve.	Zbatimi i procedures dhe rregjistrimi i saj.	Personeli autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore
		Magazinimi i materialit të trajtuar. Qeset plastike qe permbajne mbetjet e sterilizimit, do shenohen ne menyre te vecante, do vendosen ne nje thes te mbyllur deri ne momentin qe do transportohen per	Zbatimi i procedures dhe rregjistrimi i saj.	Personeli autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikatorët e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
		asgjësimin perfundimtar.			
		<p>Analizat mikrobiologjike, ne rast se jane te nevojshme sherbejne per te konfirmuar vertetesine e procesit te sterilizimit ne kohe, kryhen nga laboratore spitalore te klientit ose struktura te akredituara per procedura te tilla dhe mund te behen mbi kampionat e mbetjeve, te ajrit te ujit, te prodhuara gjate trajtimit, duke respektuar rregullat operative te trajtimit. Analiza mbetjeve eshte e percaktuar sipas paramentrave mikrobiologjik te "Farmakopea Nderkombtare". Kerkimi shkencor, (varet nga praktikat e vendit) kryhet mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bacillus cereus, • Candida albicans, • Klebsiella polmonite, • Pseudomonas aeruginosa 	Zbatimi i procedures dhe rregjistrimi i saj. Diposnibiliteti i testeve.	Personeli i autorizuar i subjektit	Sipas planit perkates te monitorimit/testimit
		Siguria e ambienteve ku zhvillohet trajtimi. Ambientet ku zhvillohet trajtimi dhe zonat ku behet karikimi i mbetjeve, duhet te jene te	Zbatimi i procedures dhe rregjistrimi i saj.	Personeli i autorizuar i subjektit	E vazhdueshme/ditore

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikatoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
		mbyllura me celes, ne momentin qe eshte kryer puna. Te ndalohej hyrja e personave te pa autorizuar edhe kur makinerite jane te fikura, sepse rrezikon dhe kontrollin e sigurise qe do behet ne fund te dites se punes.			
4.	Transporti i mbetjeve nga qendrat shendetsore/klinika/spitale etj ne impiantet e trajtimit	Sigurimi i automjeteve te posaçme dhe te etiketuara per te informuar qellimin e perdorimit te tyre	Leje qarkullimi automjeteve te transportit, per pershtatshmerin e e tyre per transportin e mbetjeve spitalore	Personi pergjegjes per transportin e mbetjeve	E vazhdueshme/ditore
Sigurimi i mjeteve te sigurise (kosha, qese, solucione pastrimi etj) qe do perdoren ne rast te demtimit te ambalazheve qe kane mbetje gjate transportit.		Leje qarkullimi automjeteve te transportit, per pershtatshmerin e e tyre per transportin e mbetjeve spitalore	Personi pergjegjes per transportin e mbetjeve	E vazhdueshme/ditore	
Zbatimi i procedures se miratuar dhe regjstrimi i mbetjeve te tranportuara dhe		Regjstrimi i mbetjeve te	Personi pergjegjes per transportin e	E vazhdueshme/dit	

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikatoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
		magazinuara për trajtim.	transportuara dhe magazinuara për trajtim.	mbetje	ore
		Siguria dhe higjiena e automjeteve të transportit	Rregjistri i larjes dhe dezinfektimit	Rregjistri i larjes dhe dezinfektimit	E vazhdueshme/ditore
5.	Dorezimi tek vendet e miratuara të depozitimit përfundimtar	Percaktimi i vendepozitimeve të licencuara që mund të sigurojnë depozitimin e sigurtë dhe ligjor. Marrveshja paraprake me administratën e vendepozitimeve dhe kompanitë e licencuara për mbetje.	Disponimi i lejeve dhe miratimeve respektive; Disponimi i një marrëveshjeje ligjore; Disponimi i formulareve të dorezimit të mbetjeve.	Personeli i autorizuar i subjektit	
6.	Trajnimi i personelit dhe testimit periodik	Organizimin e kurseve të formimit/trajnit të personelit të strukturave sanitare mbi menaxhimin e mbeturinave spitalore, sidomos për të reduktuar kontaktin e materialeve të pa infektuara me burime të mundshme infektive.	Procesverbalet e mbajtura për çdo trajnim	Subjekti	Sipas planit të posatshe të trajnimeve.

Nr.	Cikli i procesit	Masat	Indikoret e monitorimit	Rolet dhe përgjegjësitë	Koha, periudha
7.	Hartimi i procedurave/ formateve standart te operacioneve			Subjekti	Te perhershme/vazhdueshme